

STATUTI I SHOQERISE

"SHEHU" SHPK

Shoqeria "Shehu" shpk eshte krijuar ne baze te Aktit te Themelimit nga ortaku I vetem Z.Nadir Shehu i biri Abazit ne Berat ,banues ne Pobrat, Berat, I identifikuar me leternjoftimin me Nr.027161460 .

Ne perputhje me kerkesat e nenit 95 & 230 "Vijimi I funksionimit dhe detyrimi per pershtatje, te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare".....

Ortaku I vetem harton Statutin e shoqerise si me poshte:

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1: Data e Themelimit,Emri dhe Themeluesit

Shoqeria "Shehu" shpk eshte krijuar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me akt themelimi date 02.05.1995 dhe rregjistruar si person juridik me vendimin e Gjykates Tirane Nr 10708 date 09.05.1995.

Themeluesi I shoqerise "Shehu",si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (SHPK) eshte z Nadir Shehu dhe adresa e shoqerise eshte: Pobrat, Berat.

Neni 2: Objekti

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise te saj Tregeti karburante me shumice e pakice,import e eksport,tregetimin me pakice dhe me shumice ushqimore,pjese kembimi, transport kombetar e nderkombetar etj.

Neni 3: Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do te jete pa afat,duke filluar nga data e regjistrimit te saj ne Gjykatën e rrethit te Tiranës si dhe ne organet Tatimore.

Ky afat mund te ndryshohet ne perputhje me kerkesat e ligjit te siperpermendur dhe Statutit te Shoqerise ,me Vendim te Asamblese te jashtezakonshem te ortakut.

Neni 4: Selia ,Adresa e Faqes te Internetit dhe Adresa Elektronike

a) Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: Pobrat, Berat.

b) Adresa e Shoqerise per komunikim elektronike eshte: shpk.shehu-sh.p.k@live.com

KREU II

Kapitali I Regjistruar



Neni 5: Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar

Kapitali themeltar I shoqerise eshte 18.000.000 . Pjesmarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e tyre te meposhtem :

Ortaku themelues I shoqerise Nadir Shehu.

Lloji I kontributit : (kontribut I akumuluar ne vlere)

Kuota e Zoterimit te kapitalit te shoqerise 100%

Vlera totale e kapitalit te regjistruar: 18.000.000.

Neni 6 : Kerkesa per te paguar kuotat dhe terheqja e kuotave te papaguara

a). Administratori mund t'u kekojne ortakeve te shoqerise pagesen e kontributeve te pashlyera ne lidhje me kuotat e tyre dhe c'do ortake (pas marrjes se njoftimit prej 14 ditesh te plota ne te cilin percaktohet koha dhe vendi I kryerjes te pageses) i paguan shoqerise shumen e kerkuar per kuotat e zoteruara.Njoftimi per pagese mund te parashikoje shlyerjen me keste te kontributeve te paguara.Personi te cilit i drejtohet njoftimi per pagesen e kontributeve do te jete pergjegjes per njoftimet qe i drejtohen atij pavarsisht kalimit te mepasshem te pronesise se kuotave me te cilat lidhet njoftimi per pagese.

b) Zoteruesit e perbashket te nje kuote do te jene pergjegjes bashkerisht dhe ne menyre solidare per shlyerjen e kontributeve,sipas njoftimit te mesiperm.

c) Ne raste se pas njoftimit per shlyerjen e kontributeve pagesa perkatese nuk kryhet Brenda afatit te parashikuar,personi pergjegjes per shlyerjen e kontributeve do te paguaj nje interes mbi Shumen e papaguar me nje kamatvonesë pre 4% ne vit duke filluar nga dita e parashikuar per pagesen

d) Ne raste se pas njoftimit per shlyerjen e kontributeve , pagesa nuk kryhet Brenda afatit te parashikuar,Administratori mund te njoftoje parprakisht te pekten katermbedhete dite te plota personi pergjegjes per shlyerjen e kontributeve,duke i kerkuar pagesen e shumes se pashlyer se bashku me shumet e mundshme shtese te kamatvoneses.Njoftimi do te permbaje vendin ku duhet te kryhet pagesa dhe deklaimin se ne rast moszbatimi te tije , kuotat te cilave u referojhet njoftimi do te anulohen.

e) Nese pagesa nuk kryhet brenda afatit te njoftimit, kuota me te cilin lidhet njoftimi,perpara se te kryhet pagesa e kerkuar sipas njoftimit ,mund te anulohet me vendimin e Administratoreve dhe anulimi do te perfshije te gjithë dividendet ose shumta te tjera te pagueshme deri ne momentin e anulimit.

f) Ne pajtim me dispozitat ligjore ,kuota e anuluar mund te shitet,rishperndahet ortakeve ose kalohet sipas afatave dhe menyrave qe Administratoret konsiderojne te pershtatshme.

g) Personi, kuota e,te cilit esht e anuluar, humbet cilesine e ortakut ne lidhje me kete kuote por do te jete pergjegjes ndaj shoqeris per te gjitha kontributet qe do te shlyeshin nga ky ortake ndaj shoqerise ne daten e anulimit te kuotes se bashku me kamatvonesen e llogaritur per keto kontribute perpara anulimit te kuotes.



Neni 7: Lloji I Kuotave te Drejtave dhe kufizimeve

Ne perputhje me dispozitat e Liugjit dhe pa cenuar te drejtat qe rrjedhin nga kuotat ekzistuese,kuotat mund te emetohen me te drejtat ose kufizimet e parashikuara ne vendimin e Asamblese te Pergjithshme,te marre me shumicen e kualifikuar(tre te katertat)te votive te ortakev,ne perputhje me parashikimet e nenit 87 te Ligjit.

Neni 8 : Certifikatat e kuotave

Secili ortake ka te drejte te perfitoje nje certificate per kuoten e zoteruar prej tij.Shoqeria nuk eshte e detyruar te leshoje me shume se nje certificate per kuotat e zoteruara bashkarisht engu disa persona dhe dorezimi I certificates ndaj perfaqesuesifte zoterimit te perbashket te kuotave do te konsiderohet si dorezim I kryer ndaj te gjithe zoteruesve te kuotave,ne perputhje me piken 2 te nenit 72 te Ligjit.Emrat e zoteruesve te perbashket te kuotave do te renditenn ecertifikaten e kuotes.Certifikata nuk do te gezoje cilesine eletres me vlere.

Neni 9: Kalimi me Kontrate I Kuotave

- a) Kontarta e kalimit te kuotes behet me shkrim dhe sipas formaliteteve te percaktuara nga Administratoret.Kjo kontrate do te dergohet ne seline e shoqerise.
- b) Administratoret mund te refuzojne regjistrimin e kalimit te kuotes ne QKR ne rastes se kjo kuote nuk eshte shlyer plotesishte ose ne raste se Administratoret nuk jane dakord me personin te cilit I kalon kuota.
- c) Nese Administratoret refuzojne te regjistrojne kalimin e kuotes ,ata do te njoftojne per mospranimin personin te cilin I kalohen kuota,Brenda nje muaji nga data ne te cilen eshte paraqitur ne shoqeri kerkesa per regjistrimin e kalimit te kuotes.

Neni 10: Kalimi Kuotave me Trashegimi ose si pasoje e Falimentimit

- a) Nese nje ortak vdes,trashegimtari ose trashegimtaret ne rastin e bashkezoterimit te kuotave,dhe trashegimtaret e tij ne rast se ky person ishte zoterues ose trashegimtare I vetem I bashkezoteruesve te kuotave,do te jene personat e vetem te njohur nga shoqeria si gezues se te drejtes mbi kuoten e tij;pavasarshit parashikimit te ketij Statuti,pasuria e ortakut te vdekur nuk clirohet nga pergjegjesia ne lidhje me kuoten e zoteruar nga ai vetem apo se bashku me persona te tjere.
- b) Personi qe fiton te drejten mbi nje kuote si pasoje e vdekjes ose falimentimit te nje ortaku,pas paraqitjes se provave te kerkuara nga Administratoret,mund te zgjedhe te behet zoterues I kuotes ose te kerkoje regjiostrimin e kuotes ne emer te nje personi tjeterte te caktuar prej tij si perfitues te kuotes.Nese personi I mesiperm zgjeth te behet zoterues I kuotes,ai njofton shoqerine ne lidhje me kete zgjedhje.Nese ky person zgjeth qe nje person tjetet te regjistrohet si zoterues I kuotes,ai kalon kuoten ne dobi te personit tjetet.
- c) Personi qe fiton te drejten mbi nje kuote si pasoje e vdekjes ose falimentimit te nje ortaku do te kete te drejtat qe gezonte zoteruesi I kuotes,duke perjashtuar te drejten e pjesmarrjes ose te votes ne c'do mbledhje te Asamblese te Pergjithshme,dei ne momentin e regjistrimit neQKR.

Neni 11: Zmadhimi dhe Zvogelimi I Kapitalit Themeltare

- a) Asambleja e pergjithshme,me shumice te kualifikuar,mund te zmadhoje kapitalin themeltare te shoqerise duke rritur kuotat e ortakeve ekzistues ne shumen e



percaktuar ne vendimin perkates.Zmadhimi I kapitalit me qellim pranimin e ortakeve te rinj ne shoqeri,miratohet nga Asambleja e Pergjithshme me shumicen e kualifikuar te votave te ortakeve.

b)Shoqeria mund te vendose zvogelimin e kapitalit themaltar te shoqerise me vendimin e Asamblese se Pergjithshme ,te marre me shumicen e kualifikuar te votive.

Neni 12: Blerja e Kuotave te Veta

Shoqeria mund te bleje kuotat e veta dhe te kryej pagesa per blerjen e tyre ,jo nga fitimet e shoqerise qe do t'u shperndahen ortakeve apo emetimi I kuotave te reja vetem nese shoqeria permbush kushtet per shperndarjen e fitimeve sipas nenit 77 te Ligjit dhe Administratoret leshojne nje certificate te aftesise paguese te parshikuar nga ky nen.Ne raste se blerja e kuotave te veta nuk eshte ne perputhje me kushtet e nenit 77 te Ligjit,padite mbi pergjegjesite e shoqerise mund te ngrihen ne pajtim me parashikimet e nenit 78 dhe 79 te Ligjit.

Kreu III

Asambleja e Pergjithshme

Neni 13: Thirrja e Asamblese te Pergjithshme

- a) Administratoret therrasin Asamblene e Pergjithshme dhe,me kerkesen e ortakeve sipas nenit 84 te Ligjit,do te procedojne me thirrjen e Asamblese se Pergjithshme.
- b) Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi te derguar me poste ose poste elektronike (*email*) drejtuar c'do ortaku,perfshire edhe perfaqesuesin e kuotave ne zoterim te perbashket.Njoftimi me shkrese apo me poste elektronike duhet te permbaje vendin,daten,oren e mbledhjes dhe rendin e dites dhe tu dergohet te gjithe ortakeve jo me vone se shtate dite kalendarike.Secili ortak,se bashku me njoftimin per mbledhje,I dergohet edhe numeri PIN per te mundesuar pjesemarrjen dhe votimin elektronik ne mbledhje.
- c) Mbledhjet e Asamblese te Pergjithshme jane te pavlefshme ne raste moskryerje te paqellimshme se njoftim apo mos-marrjes se njoftimit te mbledhjes nga personat te cilet kane te drejte te marrin kete njoftim,me perjashtim te rastit kur shoqeria provon se personi I ka dhene shoqerise nje adrese te pasakte.

Neni 14: Mbledhja e Asamblese te Pergjithshme

- a) Asambleja e Pergjithshme merr vendime te vlefshme vetem me arritjen e kuorumit te parashikuar nga neni 86 I Ligjit.Ortaket ose perfaqesuesit e autorizuar mund te marrin pjese nepermjet mjeteve elektronike,pertshire telekoferencen (*conference call*), audio ose audio-video,ne perputhje me nenin 88 te Ligjit.Ortaket qe marrin pjese me mjete komunikimi elektronik kane te drejte te votojne nepermjete numerit PIN qe ju eshte derguar se bashku me njoftimin per mbledhjen e Asamblese te Pergjithshme.
- b) Administratoret caktojne Kryetarin e mbledhjes si edhe nje persone per te mbajtur procesverbalin.

- c) Nëse asnjë Administratore nuk dëshironë të caktohet si Kryetar i Mbledhjes ose nëse asnjë prej Administratoreve nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, ortaket e pranishëm edhe me të drejtë vote zgjedhin njerin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.
- d) Administratori, pavarësisht se nuk është ortak, ka të drejtën e pjesëmarrjes si dhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë të Përgjithshme.
- e) Kryetari, me pelqimin e Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur në përputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund (dhe është i detyruar nëse kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme), të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, por në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e asamblesë së Përgjithshme shtyhet të pakten katërmbëdhjetë ditë, njoftimi do të kryhet të paktenshtatë ditë të Plotës përpara kësaj date dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes të shtyrë dhe përshkrim i përgjithshëm i rendit të ditës. Në rast të kundërt, dhenja e njoftimit nuk është e nevojshme.
- f) Asambleja vendos me votim të hapur me përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohet në mënyrën e duhur një votim i fshehtë. Votimi i fshehtë mund të kërkohet nga:

1. Kryetari ;

2. Një ortak ose ortaket që përfaqësojnë pesë përqind të kapitalit themeltarë të shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një përfaqësues i autorizuar i ortakut ka të njëjtën vlerë me kërkesën e paraqitur nga vete ortaku.

- g) Me përjashtim të kundërshtimit të ortakut, deklarimi i Kryetarit se vendimi është marrë në mënyrë unanime, ose me një shumicë të caktuar dhe regjistrimin përkatës në procesverbalin e mbledhjes përben provën përfundimtare të këtij fakti, pa pasur nevojë për numërimin e votive të regjistruara pro ose kundër vendimit.
- h) Në rast se ka kundërshtim për këto deklarata, do të zhvillohet një votim i fshehtë lidhur me përcaktimin e numërit të votive pro dhe kundër vendimit.

Neni 15 : Votat e Ortakeve

- a) Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë i jep ortakut (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose ortakut (në rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjorë apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.
- b) Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë të Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer teresisht detyrimet që kanë të bëjnë me këto kuote.
- c) Çdo kundërshtim në kohë për çelësin e një votuesi do të komunikohet Kryetarit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtarë. Të gjithë votat pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të jenë të vlefshme.

Neni 16: Votimi me Prokurë

Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterzuar apo e miratuar nga Administratoret depozitohet në selinë e shoqërisë ose në një vend tjetër brenda territorit të Republikës të Shqipërisë, sic përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Akti i emerimit të përfaqësuesit

duhet te depozitohet jo me vonë se 48 ore përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

Në rast se akti i emerimit të përfaqësuesit jepet nëpërmjet komunikimit elektronik të dërguar në adresë elektronike (*email*) sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit 4, të këtij Statuti, ky akt duhet të merret jo më vonë se 48 ore përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

Neni 17: Hetimet e posaçme

Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emerimin apo zëvendësimin e një eksperti të fushës sipas nenit 91 të Ligjit paraqesin kërkesë të tillë nëpërmjet depozitimit të një deklarate noterjale në selinë e shoqërisë e cila vërteton se personi ose personat plotësojnë kushtet për kryerjen e këtij veprimi.

Kreu IV

Administratoret

Neni 18: Emerimi i Administratoreve

- a). Asambleja e përgjithshme zgjith një ose më persona fizik si Administratore të shoqërisë për një periudhë pesëvjeçare, në pajtim me parashikimet e shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 18 dhe nenit 95 të Ligjit. Emerimet do të individuale dhe sipas një vendimi të marre me shumicë të zakonshme nga Asambleja e Përgjithshme, i cili, nëse miratohet, sjell emerimin e personit të propozuar si Administrator.
- b). Kufizimet në lidhje me emerimin e Administratoreve parashikohen në pikën 2 të nenit 95 të Ligjit. Administratori Nadir Shehudo të caktohet si Kryetar i mbledhjes të Administratoreve deri në zgjedhjen nga mbledhja e parë e zakonshme.

Neni 19: Kompetencat e Administratoreve

Politikat tregëtare të shoqërisë do të administrohen nga Administroret të cilët mund të ushtrojnë të gjithë kompetencat që nuk i refuzohen Asamblese të Përgjithshme sipas nenit 81 të Ligjit. Ndryshimet e statutit nga Asambleja e Përgjithshme dhe udhëzimet e Asamblese së Përgjithshme nuk do të shfuqizojnë aktet e mëparshëm të Administratoreve, të cilat do të ishin të vlefshëm nëse ndryshimi nuk do të ishte kryerë ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë.

Administroret mund t'ua delegojnë kompetencat e tyre çdo komiteti i cili përbehet nga një ose më shumë Administratore. Çdo delegim kompetencash mund të kryhet në përputhje me kushtet që mund të vendosin Administroret dhe mund të revokohet ose ndryshohet. Administroret nuk mund të delegojnë detyrimet e tyre ligjore.

Neni 20: Skualifikim dhe Shkarkimi i Administratoreve

Detyra e Administratorit përfundon në raste se:

1. personi nuk është Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimin e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
2. personi ndodhet në gjendje pa aftësi paguese;
3. personi vuan ose mund të vuaj nga crregullime mendore:

4.personi jepdoreheqje nga detyra duke njiftuar shoqerine,ose

5.ka munguar me shume se gjashte muaj radhazi pa lejen e Administratoreve te tjere ne mbledhjet e Administratoreve te mbajtura gjate kesaj peridudhe dhe Asambleja e Pergjithshme,me propozimin e Administratoreve,vendos ta shkarkoje nga detyra.

Neni 21 : Mbledhjet e Administratoreve

- a) Mbledhjet e Administratoreve do te mbahen sipas nevojave te aktivitetit tregetar te shoqerise
- b) Vendimet e mbledhjes se Asamblese merren me kurumin e votive qec mund te percaktohet nga Administratoret,dhe ne rast se ky kurum nuk eshte percaktuar ai do te jete dy
- c) Asambleja e Pergjithshme cakton njerin prej Administratorev me detyren e Kryetarit te mbledhjes se Administratoreve,I cili mund te shkarkohet ne c'do kohe nga kjo detyre.Kryetari do te drejtoje c'do mbledhje te Administratoreve ne te cilat ai eshte I pranishem.Ne rast se Kryetari nuk deshiron te drejtoje mbledhjen apo nuk eshte I pranishem Brenda pese minutave nga ora e caktuar per mbledhjen,Administratoret e parrishem mund te emerojne njerin prej tyre si Kryetar te mbledhjes
- d) Ceshtjet e rendit te dites vendosen me shumicen e votive te pjesemarresve.Ne raste numri te barabarte votash ,vota e Kryetarit do te jete vendimtare.
- e) Te gjitha aktet e kryera nga mbledhja e Administratoreve,ose nga komiteti I Administratoreve,apo nga persona te cilet veprojne si Administratore,pavarsishte nese behet e ditur me vone se ka pasur mangesi ne emerimin e nje Administratori ose njeri prrj tyre ka qene I skualifikuar nga mbajtja e kesaj detyre,ose nuk kishte te drejte te votonte,do te konsiderohen te vlefshme njelloj sikur keta persona te ishin emeruar rregullisht dhe te ishin cilesuar e te vazhdoniin detyren si Administratore dhe te kishin te drejte te votonin ne mbledhje.
- f) Vendimi me shkrim I nenshkruar nga te gjitha Administratoret qe kane te drejte te njoftohen per mbledhjen e Administratoreve do te konsiderohet si I vlefshem dhe I efektshem njelloj sit e ishte miratuar ne mbledhjen e Administratoreve,e mbledhur dhe e zhvilluar rregullisht.

Neni 23 : Kufizimet ne Votimet e Administratoreve

- a) Administratoret nuk do te lidhin marreveshje ose votojne ne mbledhjen e Administratoreve per ceshtje ne te cilin keta anetare kane ,direct ose indirect,nje interes apo detyrim I cili eshte materjal,qe eshte apo mund te jete ne kundertshtim me interes e shoqerise,ne pajtim me nenin 13 te Ligjit,deri ne momentin kur ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme,te gjitha anetaret kane rene dakord qe:
 - 1.te autorizojne lidhjen e kesaj merrveshje dhe
 - 2.te autorizojne kete anetare qe te votoje ne lidhje me kete ceshtje
- b) Vota e Administratorit nuk do te llogaritet ne kurumin e pjesemarresve ne mbledhjen ne lidhje me vendimin per te cilin ky anetare nuk ka te drejte te votoj.Dispozitat e nenit 89 te Ligjit do te zbatohen lidhur me perjashtimin e Administratorit nga vendimet e marra ne kete mbledhje.
- c) Ne raste se ne mbledhjen e Administratoreve ose te komitetit te Administratoreve diskutohet nje ceshtje e lidhur me te drejten e votes se nje Administratori,ceshtja mund di drejtohet Kryetarit te mbledhjes ,perpara perfundimit te mbledhjes,dhe vendimi I tij lidhur me cdo Administratore te ndryshem nga ai vete do te jete perfundimtare dhe I forms se prere.



Neni 24: Procesverbalet e Mbledhjes te Administratoreve

Administratoret kujdesen qe ne librat te posacem te mbahen procesverbalet e :

1.te gjitha takimet e kryera nga Administratoret; dhe

2.te gjitha mbledhjeve te Asamblese se Pergjithshme ,mbledhjeve te Administratoreve dhe komitetit te Administratoreve,perfshire edhe emrat e Administratoreve te pranishem ne keto mbledhje.

Kreu V

Dividentet dhe Kalimi I Fitimit ne Kapital Themeltare

Neni 25 : Dividentet

a).Pas plotesimit te parashikimeve te nenit 77 te Ligjit,shoqeria me shumice te kualifikuar te votive se Asamblese te Pergjithshme mund te deklarojne shperndarjen e dividendit ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakeve.

b).Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga te drejtat qe lidhen me kuotat,te gjithë dividendet deklarohen dhe paguhen ne perputhje me shumate e paguara per kuotat per te cilat paguhet dividend.Te gjithë dividendet pjestohen dhe paguhen ne perpjestim tec drejte me shumate e paguara per kuotat,pjeses ose pjeseve te periudhes per te cilen paguhet dividenti;ne raste se kuota emerohet me kushtin e perfitimit te dividendit nga nje date e caktuar ,dividenti do te paguhet ne perputhje me kete kusht.

c).Asnje dividend ose pagese ne para qe lidhet me nje kuote nuk do te mbarfte interesa ndaj shoqerise nese nuk parashikohet nga te drejtat qe lidhen me kuote.

d). Cdo dividend qe nuk eshte kerkuar te paguhet brenda dymbedhete vjeteve nga data e maturimit,ne raste se vendoset me shumice te kualifikuar votash nga Asambleja e Pergjithshme, do te perfitohet nga shoqeria e cila nuk do te jete me e detyruar qe te paguaj ate.

Neni 26: Kalimi I Fitimit ne Kapitalin Themeltar

Administratoret,pas vendimit te marre nga Asambleja e Pergjithshme me shumice te kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e percaktuara ne nenin 14 te Ligjit ,mund te vendosin te kalojne ne kapitalin themeltar te shoqerise fitimet e pashperndara te cilat nuk do te perdoren per te paguar dividente preferenciale apo shuma te tjera te parashikuara per rezervat e kapitalit te shoqerise.

Neni 27 : Prishja dhe likujdimi

Ne rast te likujdimit te shoqerise,likujduesi,ne perputhje me Ligjin dhe me vendimin e marre me shumicene kualifikuar se votes te Asamblese se Pergjithshme,mund te shperndaje ne dobi te ortakevete gjithë ose nje pjese te vleres se pasurise te shoqerise dhe per kete qellim,mund te vleresoje cdo pasuri dhe te percaktoje menyren e shperndarjes midis ortakeve te shoqerise.

Neni 28 : Njofitimet



a).Njoftimet e kryera nga cdo person sipas parashikimeve te Statutit ,duhet te jene me shkrim ose (nese zbatohet) nepermjet komunikimit elektronik ne adresen e parshikuar sipas pikes 3 te nenit 4 te ketij Statuti dhe jane te vlefshme ne lidhje me kohen e njoftuar per kete qellim dhe personin qe kryem njoftimin

b).Shoqeria mund te njoftoje nje ortak personalisht ose duke njoftuar me leter porosi me kthim pergjigje ne adresen e regjistruar te ortakut ose ne adresen apo posten elektronike (nese ka)qe l eshte njoftuar shoqerise nga ortaku.Kur ka disa bashkezoterues ten je kuote,te gjitha njoftimet l jepen perfaqesuesit te tyre te perbashket ne perputhje me piken 2 te nenit 72 te Ligjit.

c).Ky statut se bashku me ndryshimet dhe te gjitha dokumentet e tjera ,raportet,komunikimet dhe procesvebalet e dhena nga shoqeria do te publikohen nga Administratoret ne faqen e internetit te shoqerise ,sipas parashikimeve te pikes 2 te nenit 4 te ketij Statuti

Emrat dhe nenshkrimi l Ortakeve Themelues:

...NADIR SHEHU.....



Nadir Shehu
N/S

Berat 20/05/2011

